



Departamenti i Prokurimit

Prishtine datë, 19.08.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 17.08.2021 të parashtruar nga Grupi i Operatori Ekonomik “**Matkos PharmSHPK**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me material shpenzues mjekësor”, me Nr. të Prok: 616 21 3547 121 nxjerr:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik “**Matkos Pharm**”, të dt. 17.08.2021 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me material shpenzues mjekësor”, me Nr. 616 21 3547 121, kundër Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, të datës 13.08.2021.
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te kthej ne rivlerësim aktivitetin e prokurimit*;
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Grupi i Operatori Ekonomik “**Matkos Pharm shpk**” me datë 17.08.2021, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “me material shpenzues mjekësor”, me Nr. 616 21 3547 121.

Autoriteti Kontraktues, me datë 19.08.2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë dhe ka konstatuar si vijon :

-Pretendimi lidhur me autorizimin e tenderuesit të propozuar për dhënje të kontratës “Komed L.L.C.”rezulton të jetë i bazuar,pasi që sipas konfirmimit që e kemi marrë nga prodhuesi “Aquila Group” rrjedh se OE-ik “Pharma Group”që e ka lëshuar autorizimin nuk është im autorizuar për lëshim të autorizimeve për OE-ik tjerë,por për këtë aktivitet sipas deklaramit të prodhuesit “Aquila Group” i vetmi OE-ik i autorizuar në Kosovë është “Matkos Pharm”;

-Poashtu edhe pretendimi lidhur me katalogun është i bazuar,sepse edhe përkundër kërkesave për sqarime të kërkuara nga komisioni tenderuesi nuk ka arrijtur të dorëzojë katalog sipas kërkesave të FDT-së.

Bazuar në këtë kam vendosur që aktiviteti të kthehet në rivlerësim dhe çdo veprim në atë fazë të jetë në harmoni me dispozitat ligjore duke përfshirë verifikimin e të gjitha dokumenteve të dorëzuara nga tenderuesit.

Zyrtari përgjegjës nga Departamenti i Prokurimit duhet të kërkojë formimin e komisionit të rivlerësimit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Shtojcë:Kërkesa për sqarim nga prodhuesi dhe sqarimi i pranuar.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Datë/a:	18.08.2021
Referenc-ë:	Kërkesa per rishqyrtim e OE-ik "MatkosPharm" lidhur me aktivitetin "Furnizimi me material shpenzues mjekësor"
Për/ Za/ To:	Aquila Group SHPK-Tiranë
Nga/ Od/ From:	Zekë Bardhaj, Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit
Tema/ Subjekat/Subject:	Kërkesa për sqarime lidhur me autorizimet për pjesëmarrësit në tender

Të nderuar,

Në ofertën e vet tenderuesi "Komed L.L.C." ka dorëzuar një autorizim për pjesëmarrje në tender nga OE-ik "Pharma Group", i cili është deklaruar se është distributor i prodhimeve tuaja. Tenderuesi tjetër ka dorëzuar deklaratat tuaja sipas të cilave i njëjti "MatkosPharm" është i vetmi i autorizuar nga ju për pjesëmarrje në këtë aktivitet.

Bazuar në këtë kërkesë sqarimin si vijon:

- A është i autorizuar OE-ik "Pharma Group" si distributor i prodhimeve tuaja si që është deklaruar dhe nëse jo atëherë si pati mundësi të dorëzoj certifikatat tuaja;
- Apo autorizimin për distribuim të prodhimeve tuaja dhe pjesëmarrje në tender në territorin e Kosovës e ka vetëm OE-ik "MatkosPharm"?

Përgjegjja juaj do të na ndihmoj në marrjen e veprimeve të drejta në vazhdim të procedurës.

Shkresë i bashkëngjisim:

- Autorizimin dhe certifikatat e dorëzuara nga tenderuesi :Komed L.L.C. dhe
- Deklaratat tuaja lidhur me tenderuesin "MatkosPharm".

Me respekt,

Datë 19-08-21
Për : Zekë BARDHAJ, Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit
Nga: Edmond ZISO , Administrator i Aquila Group sh.p.k
Tema: Sqarime lidhur me autorizimet për pjesëmarrje në tender

Përschendetje ,

Gjeni më poshtë përgjigjet për pyetjet që ju keni ngritur:

1. Pharma Group nuk është distributor eskluziv (i vetëm) i AQUILA GROUP në Republikën e Kosovës dhe nuk ka të drejtën e lëshimit të autorizimeve për të dytë dhe të përdorë dokumentat e kompanisë tonë pa miratimin paraprak nga ana jonë.
2. Autorizimi për të marr pjesë në këtë tender me numer prokurimi **616-21-3547-1-2-1** i është dhënë nga ne vetëm kompanisë Matkos Pharm.

Me respekt ,

Administratori

Edmond ZISO

